



## **Sfida e pëmirësimit të raportimit për fëmijët në median audiovizive**

### **Arben Muka**

Në dy vitet e fundit, 2020 dhe 2021, ka pasur thuajse një nivel të barabartë, rreth 35%, të ankesave që kanë mbërritur në Autoritetin e Mediave Audiovizive, AMA, për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e papërshtatshme apo cënimin e privatësisë së tyre. Nëse do t'i referohemi të dhënave edhe për vite të mëparshme, sërish kjo kategori ankesash është në vend të parë. Ndjeshmëria për respektimin e standardeve profesionale dhe etike në transmetimet audiovizive për/me fëmijët nuk është vetëm tek redaksitë e subjekteve të licencuara, por edhe në rradhët e publikut, institucionet dhe organizatat që angazhohen në këtë sektor.

Ankesat që mbërrijnë në AMA nuk janë burimi i vetëm për vlerësimin e situatës. Paralelisht institucioni, në mënyrë periodike, monitoron dhe shqyrton përmbajtjet audiovizive nga televizionet kombëtare apo lokale/rajonale, ato të formatit gjeneralist apo tematik (të dedikuara për fëmijët).

### **Tipologjia e problemeve që hasen**

Rastet e identifikuar si shkelje ose injorim i kërkesave të Ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kodit të Transmetimit, si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi, ndahen me komunikim shkresor dhe me kontakt të drejtpërdrejtë me redaksitë televizive. Mbrojtja e fëmijëve nga transmetimet e papërshtatshme audiovizive mbetet prioritet për Autoritetin, si institucion rregullator jo vetëm nga detyrimi për të respektuar kërkesat e Ligjit organik 97/2013, por dhe nga domosdoshmëria e zbatimit të Kushtetutës së Shqipërisë, e cila i përcakton fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja të kenë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti, përcaktim që shoqërohet me obligime për ligjvënësin.

Direktiva Evropiane për Shërbimet Audiovizive, e aktualizuar në fund të vitit 2018, ka theksë prioritare në përmbajtjen e saj për mbrojtjen e fëmijëve, të detyrueshme për t'u zbatuar nga shtetet anëtare të BE-së, por që në një të ardhme të afërt do të jenë po të detyrueshme të përfshihen dhe në legjislacionin e Shqipërisë, si një vend aspirant për t'u anëtarësuar me të drejta të plota në familjen evropiane. Po ashtu detyrues mbetet dhe zbatimi i kërkesave të

Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 20 nëntor 1989, të cilën vendi ynë e ka rafifikuar 30 vite më parë.

Në monitorimin dhe shqyrtimin e përmbajtjeve audiovizive të transmetuara vëmendja kryesisht fokusohen te pamjet e rënda nga ngjarje të kronikës së zezë (paraqitja në distancë të afërt e viktimave); programet e fëmijëve; ekspozimi i fëmijëve pa filtra, (kur japin opinionone, intervista etj); përfshirja e të miturve në reklamat dhe komunikimet tregtare; katalogu i këngëve në kanalet muzikore etj. Orari i transmetimit; përdorimi i shenjave paralajmëruese; si dhe aplikimi i teknikave të mbulimit (mosidentifikimit) janë ndër elementët që vlerësohen më së shumti në analizat e përmbajtjeve të monitoruaranga AMA.

Në rastet e pasqyrit të ngjarjeve të rënda është i dukshëm reflektimi profesional nga televizionet kombëtare në 2-3 vitet e fundit, ndërkohë që nuk mund të thuhet e njëjta gjë për televizionet lokale/rajonale, sidomos ato të formatit informativ, që në mbulimet e drejtpërdrejta, nga nxitimi për të detajizuar gjithçka ndodh në terren, përfshijnë dhe pamje të papërshtatshme për orarin, shoqëruar dhe me shpjegime që krijojnë ndjeshmëri dhe emocione të forta për shikuesit në tërësi, veçanërisht tek familjarë dhe të afërt të protagonistëve të ngjarjes.

Nga monitorimi i dinamikës së mbulimit të ngjarjeve të tilla, vihet re se redaksitë janë shumë të kujdesshme në përgatitjen e kronikave të mëvonshme që transmetohen brenda edicioneve informative, duke aplikuar teknika mbulimi, apo duke “zhveshur” tekstet shpjeguese nga sqarime të panevojshme që lidhen kryesisht me mbrojtjen e të dhënave personale, prezumimin e pafajësisë etj.

Në pjesën argëtuese programore për/me fëmijët ka raste të konsiderimit të tyre si të rritur, duke “sajuar” pyetje ose përgjigje pa u ditur kuptimin, ose duke stimuluar performanca imitimi të personazheve të njohur publikë, shoqëruar dhe me gjestikulacione që i nxjerrin jashtë natyrës së moshës dhe botëkuptimit të natyrshëm. Në komunikim me kanalet audiovizive të dedikuara muzikës, AMA ka tërhequr vëmendjen për lëvizjen e orarit për transmetimin e videoklipeve që kanë përmbajtje të demonstrimit direkt ose indirekt të veprimeve të dhunshme, pornografisë, përdorimit të alkoolit apo lëndëve narkotike, që shoqërohen me gjeste joetike etj. duke evituar fashat kohore kur mendohet se para ekranit janë të miturit.

### **Partneriteti me aktorë që punojnë në fushën e medias**

Në pozicionin e autoritetit rregullator, AMA, veç proceseve bazike të monitorimit dhe shqyrtimit të ankesave (apo kur fokusi është kryesisht) në përmbajtjet e transmetuara audiovizive, ka konsoliduar partneritetin me aktorë që punojnë në fushën e medias, OJF dhe institucione publike, sinergji që mbështetet në tri linja kryesore: kualifikime të redaksive për përmirësimin e raportimit; studime të tregut audioviziv dhe, së treti, publikim në shqip të literaturës më të mirë ndërkombëtare mbi sektorin audioviziv.

Mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme është pjesë e rëndësishme e këtij partneriteti, me shtrirje gjeografike në të gjitha qarqet e vendit, ku përfshihen gazetarë, redaktorë, menaxherë dhe bashkëpunëtorë, si nga subjektet me licencë kombëtare, ashtu dhe ato lokale/rajonale. Për të zgjeruar bazën e përfituesve, në termat e referencës për projektet e zbatuara janë përfshirë dhe publikime hard dhe soft copy të broshurave profesionale, që shpërndahen gjerësisht për redaksitë.

Përmirësimin e raportimit në median audiovizive AMA e shikon të lidhur ngushtë dhe me edukimin mediatik në rradhët e fëmijëve. Prej mesit të dekadës së kaluar ka një prirje të qëndrueshme të autoriteteve rregullatore evropiane për t'u investuar fuqishëm në edukimin mediatik të publikut, ku nxënësit janë ndër segmentet shoqërore në vëmendje të shtuar prej tyre, për t'u përfshirë në projekte gjithëpërfshirëse. AMA nuk mund të zëvendësojë rolin dhe përgjegjësinë e Ministrisë së Arsimit, apo agjencive dhe enteve të tjera publike - që direkt apo indirekt duhet të kontribuojnë për futjen e koncepteve të edukimit mediatik në kurrikulat shkollore - por e sheh veten si aktore e dobishme për kontribut konkret në këtë drejtim.

Prej vitit 2017, kur Autoriteti mbështeti projektin e parë mbi edukimin mediatik, realizuar nga Instituti Shqiptar i Medias, kanë vijuar projektet me partnerë të tjerë, duke u bazuar në formate të ndryshme produktesh komunikimi dhe interaktiviteti, si sondazhe, forume debati mes nxënësve, tryeza pune dhe konferenca, publikime të dedikuara etj. Gjithashtu AMA qaset kohë pas kohe dhe në ndryshimet e paketës së akteve nënligjore, sidomos të Kodi i Transmetimit dhe Rregullorja “Komunikimet audio dhe/ose audiovizive me natyrë tregtare: format, kushtet dhe koha ditore e lejuar për transmetimin e reklamave”, në të cilat ka seksione të veçanta për mbrojtjen e fëmijëve në transmetimet audiovizive.

### **Rishikimi tërësor i Kodit të Transmetimit**

Miratimi versionit aktual të Kodit është bërë nga AMA në vitin 2017. Kjo kohë ka qenë e mjaftueshme për t'iu rikthyer përmbajtjes së tij, jo thjesht për ndonjë retushim rutinor, por për ndërhyrje të thelluar përmirësuese, duke prekur mjaft aspekte të qenësishme që u ka “ardhur koha”, mes tyre dhe mbrojtja e fëmijëve, me qëllimin parësor të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës në të gjitha programet e transmetimit audioviziv.

Në 5 vitet e fundit ka precedenë të cilave AMA nuk mund t'u japë zgjidhje me tekstin ekzistues, ka propozime e sugjerime konkrete nga OSHMA-të, OJF-të që punojnë me të miturit, por dhe nga grupe të tjera të interesit dhe publiku, për të përfshirë kritere dhe standarde, që burojnë nga legjislacioni në fuqi, por që nuk janë prezantuar, ose janë artikulluar jo qartësisht në Kodin e vitit 2017.

Grupi ekspertizës që ka përgatitur draftin fillestar, i gatshëm që t'i nënshtrohet konsultimit publik në disa nivele, ka zgjeruar bazën e referencave në legjislacionin vendas dhe aktet ndërkombëtare, ku për seksionin e fëmijëve, psh., bazohet edhe në ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”; ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar; ligjin nr.8528, datë 23.9.1999 “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të

ushqyerit me gji”; ligjin nr.9518, datë 18.4.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”, i ndryshuar etj.

Ekspertët e kanë parë si të nevojshme në përmirësimet e Kodit të Transmetimit dhe përfshirjen e referencave nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore, (e vitit 1998), neni 8, neni 9, neni 10 dhe neni 14 dhe protokollin 12 i saj; Konventa e OKB-së “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” (1989); Konventa e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual (Konventa e Lazarotes); Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), 2011, etj.

Drafti në proces ka përcaktime të reja jo vetëm për përmbajtjet audiovizive të transmetuara nga ana cilësore, por dhe në kuptimin sasior, për shtimin e programeve të larmishme për/me fëmijët, që të “mundësojnë hapësirën e duhur dhe të përshtatshme për moshën e tyre, që ata të shprehin lirisht mendimin e tyre”. Risi për versionin e rishikuar të Kodit është dhe krijimi i mundësive nga subjektet e licencuara “për realizimin e emisioneve, programeve si dhe botimin e rubrikave për fëmijë në gjuhët e minoriteteve etnike dhe kulturore që jetojnë në Shqipëri”.

Procesi i konsultimit publik të tekstit të rishikuar pritet që t’i shërbejë rritjes së përgjegjësisë profesionale të redaksive audiovizive, në favor garantimit të një oferte cilësore dhe të shumëllojshme të katalogut të programeve për/me fëmijët, duke garantuar liritë dhe të drejtat e tyre në procesin e informimit, edukimit dhe argëtimit.